



Integrimi

Prej huajave dhe të huajve pritet, që të integrohen në shoqëri. Kjo do të thotë me ju përmbajt ligjeve, ekonomikisht me u përkujdes vetë për vetën dhe me mësue gjermanisht.

Parimet themelore më të rëndësishme

Të gjitha banoret dhe banorët në Zvicër duhet t'i përmbahen kushtetutes shtetërore (p.sh. barazia burr/grua) dhe t'iu përmbahen ligjeve ekzistuese. Pëveç kësaj pritet, që ekonomikisht njeriu të përkujdeset vetë për vetën, derisa është e mundshme. Prej të huajave dhe të huajve kërkohet, që sa më shpejt që të jetë e mundshme ta mësojnë gjuhën e vendbanimit. Mirëpo integrimi mund të bëhet vetëm nëse të dy palët japin kontribut. Për këtë pritet prej popullatës vendore hapje kundrejt të huajave dhe të huajve.

Përgjegjësia individuale

Shteti, kantonet dhe komunat përkujdesen për atë, që të huajat dhe të huajt ta kenë të drejtën e hyrjes në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore. Të huajat dhe të huajt duhet nga ana e tyre me përgjegjësi individuale të mundohen që të integrohen. Njeru pret prej tyre që ofertat e përgatitura të shfrytëzohen.

Pjesëmarrja në jetën shoqërore

Një mundësi të mirë për tu integruar në shoqërin zvicërore dhe për të njohur njerëz janë shoqatat. Mirëpo edhe festat dhe organizimet në komuna janë të përshtatshme me lidh kontakte. Ngritja mundet me qenë paksa e vështirë, jo të gjitha banoret dhe banorët në Zvicër janë njësoj të hapur kundrejt kulturave të huaja. Nganjëherë nevojitet paksa durim.

Njoftime / mbështetje

Në kantonin e Bernit për të posa ardhurit ka në dispozicion zyra të ndryshme të kontaktit. Vendi i parë i mirë për tu njoftuar është komuna. Mirëpo ka edhe pika të tjera specifike për emigrante dhe emigrant. Në kantonin e Bernit ka shumë zyra rajonale për integrim (Ansprechstellen Integration | antennes d'intégration). Këto informojnë për jetën në Zvicër dhe ju përgjigjen pyetjeve konkrete për tema të ndryshme. Kush nuk flet ende gjermanisht apo frëngjisht, mundet me e sjell dikend të përkthet apo të lus për një përkthyes apo përkthyes. Disa zyra kontakti informojnë edhe në gjuhë të tjera.



Kanton Bern
Canton de Berne

hallo-bern.ch
salut-berne.ch

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/integrimi

hallo-bern.ch

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri
Gjuha dhe integrimi / Integrimi